



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rr. "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë; Dhe

KONZORCIUMI "Ademaj Arch-ing" Shpk & "Axis G.C.W" Shpk, Komuna e Prishtines, të cilat i përfaqëson z. Valmir Ademaj, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 601616929 perkatesisht, 810192998 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

BETONIMI I KANALIT VËRSHUES TË RUDESHIT NË VRELLË – Lot 1

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-20-1415-5-2-1/ C 369 LOT 1</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 020 / 016/ 521 – LOT 1</i>

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

BETONIMI I KANALIT VËRSHUES TË RUDESHIT NË VRELLË – Lot 1

Neni 2 Çmimi

*2.1 Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit **BETONIMI I KANALIT VËRSHUES TË RUDESHIT NË VRELLË – Lot 1** është: 36.859,00 € dhe me fjalë: /Tridhjetëegjashtëmijëetëçindeepesëdhjetenëntëzerozero €*

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Afati i përmbushjes së kontratës:

4.1 Kontrata do të përmbushet ne afat prej 60 ditësh, nga data e nënshkrimit të se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 10. 12. 2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet per demet eventuale te shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për

pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:
"Ademaj arch-Ing" & "Axis G.C.W" Shpk

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Valmir Ademaj
Pozita:	Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit	Pozita:	Lider i grupit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	7. 10. 2020	Data:	07/10/2020
Vu la		Vu la	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës në afat prej 3 MUAJ
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 2 MUAJ
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

Ndertimi i kanalit te ujitjes dhe verrshues i gerdhecit ne Vrelle(vazhdim nga kanali egzistues)

Paramasa dhe parallogaria

Nr.	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi/njesi	Vlera totale
1	Hulumtimi dhe pastrimi i terenit, rrenimi i germadhve dhe mbetjeve nga kanali i vjeter (urat, presat etj.) pastrimi dhe planifikimi i terenit ne te dy ane te kanalit nga dheu dhe materijal te ndryshem te hedhur buze traces ku parashifet ndertimi i kanalit . Ne çmim te kalkulohet ngarkimi dhe transporti e ni sasi te materijalit te caketuar nga organi mbikeqyres deri ne deponi me te afert . Paguhet sipas m të siperfaqes se pastruar.	m ²	5250	0.40	2100.00
2	Prerja e pemve dhe shkureve si dhe heqja e renjve buze traces ku parashihet ndertimi i kanalit ne te dy anet ,pastrimi dhe largim i tyre deri ne deponi me te afert te caketuar nga organi mbikeqyres. Paguhet sipas m të siperfaqes se pastruar.	m ²	5250	0.40	2100.00
3	Demontimi i tubacioneve egzistuese nga gypat BA-Ø400mm - Ø800mm me bartjen dhe vendosjen e tyre ne deponi te caktuar nga ana e pronarit te ngasters ku jan te vendosur.	m ²	20	5.00	100.00
4	Punimet gjeodezike ku parashihen keto punimet: Inqizimet dhe piketimet e trases para fillimit te punimeve me të gjithë parametrat te duhura si (profili gjatesor, degzimet dhe ndarjet). Percjellja e duhur te punimeve . Llogaria për m të trasës së shënuar	m ²	1300	1.00	1300.00
5	Germimi i kombinuar e dheut te kat. III dhe IV me eskavator dhe dore me gjeresi sipas prerjes terthore dhe thellesi mesatare h = 1.0 m.				0.00
6	me makine 90%	m ³	1950.00	1.00	1950.00
7	me dore 10%	m ³	195.00	1.50	292.50
8	Ngarkimi dhe transporti i dheut te germuar e duhur per perdorim me vonshemne ne deponi me te afert e te caketuar nga organi mbikeqyres.	m ³	650.00	1.50	975.00
10	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e zhavorit (0-31) mm me trashesi mesatare d = 10 cm nen pllaken dhe anve te kanalit me nivelizim te duhur ne tere gjatesin e tij.	m ³	130.00	5.00	650.00
11	Furnizimi me materijal nga deponia e materialit te germuar, shperndarja dhe ngjeshja (kompaktimi) i ketij materijalit ne shtresa (20-30)cm buze kanalit te perfunduar ne te dy ane te tij.	m ³	1230.00	0.50	615.00
12	Furnizimi me materijal te duhu ,punimi ,vendoja dhe kompaktimi i betonit te klasit C-30/37 per betonimi e pllakes dhe mureve anesore te kanalit ne pahi te duhur.	m ³	590	40.00	23600.00

14	Armimi i pjesve te kanalit sipas detaleve te armatures. Cmimi per njesi perfshin: Furnizimin,transportin,prejren,lakimin dhe vendosjen e armatures se brinjezuar S-400/500 Ø8mm - 15/15cm sipas detalit ne projekt ne projekt.	m ²	3600	0.60	2160.00
16	Furnizimi,transporti dhe vendosja e portes metalike per kontrollimin e sasis e ujit me dim. 200x100x10cm . Ne cmim te llogaritet komplet porta me mekanizem per levizen e saj.	cope	2	50.00	100.00
17	Furnizimi,transporti dhe vendosja e portave metalike per kontrollimin e sasis e ujit me dim. 50x50cm . Ne cmim te llogaritet komplet porta me mekanizem per levizen e saj.	cope	10	30.00	300.00
18	Punimi i fugave te diletimit ne cdo (10-15) m te gjatesis e se kanalit duke e perdorur shtresen e izolimit "Condor", listelat 2 x 2 cm ose stiropor d = 1cm	m'	133	0.50	66.50
19	Testimi i kualitetit te betonit ne kanal me sklerometer ne qdo(150 - 200)m gjatesi te kanalit ose sipas te urdhrave te organit mbikqyres.	cope	5	5.00	25.00
20	Pastrimi i terenit buz kanalit te ri nga mbeturina e punishtes si dhe planifikimi i dheut per gjate te kanalit ne te dy ane . Transporti i tepriices e dheu ne deponi me te afert te caktuar nga organi mbikeqyres.	m ²	5250	0.10	525.00
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT					36859.00

31236.44068